
**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË
"RISTRETO" SHPK**

- **Marenglen Skëndi**, shtetas Shqiptar, lindur në Gjirkoastër, më datë 10.02.1975, me kartë identiteti me nr.personal H50210056N;
- **Ilir Varfi**, shtetas Shqiptar, lindur në Sarandë, më datë 19.01.1989, me kartë identiteti me nr. I90119048A.

të angazhuar për të themeluar një shoqëri të re tregtare në Shqipëri, duke kuptuar plotësisht legjislacionin Shqiptar në lidhje me shoqëritë tregtare si dhe duke patur në dispozicion të gjitha mjetet e nevojshme financiare si dhe idetë për të themeluar një biznes, nëpërmjet këtij akti, të hartuar dhe nënshkruar sot më datë **20.02.2018**, shprehin vullnetin e tyre të lirë dhe angazhimin për të themeluar një "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar", si vijon:

1. Forma ligjore dhe emri i shoqërisë.

Emri i shoqërisë do të jetë **"RISTRETO" SHPK**, e quajtur më poshtë me emrin "shoqëria", e cila themelohet si një shoqëri tregtare në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "SHPK".

2. Ortakët e shoqërisë.

Ortakët e shoqërisë janë:

- **Marenglen Skëndi**, shtetas Shqiptar, lindur në Gjirkoastër, më datë 10.02.1975, me kartë identiteti me nr.personal H50210056N;
- **Ilir Varfi**, shtetas Shqiptar, lindur në Sarandë, më datë 19.01.1989, me kartë identiteti me nr. I90119048A.

3. Objekti i veprimtarisë.

Objekti i veprimtarisë do të jetë:

Bar kafe, përpunim, tregtim me shumicë e pakicë të kafesë dhe nënprodukteve të saj. Import-eksport, tregëti me shumicë e pakicë të artikujve të ndryshëm industrial, ushqimor, bujqësor e blegtoralë, fruta perime, pije të të gjitha llojeve, etj. Transport mallrash të të gjitha llojeve, brenda dhe jashtë vendit. Hapja, menaxhimi dhe shfrytëzimi të cdo lloji dhe madhësie të bareve, restoranteve, hoteleri turizëm, fast-food dhe lojrash argëtuse për fëmijë. Në fushen e agjentimit, dizajnit, brandimit, paketimit, publicitetit dhe prodhimit të materialeve publicitare, krijimit dhe publikimit të tyre në cdo lloj material apo forme tjetër reklamuese.

Shoqëria mund të kryejë çfarëdo veprimtarie tjetër që lejohet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

4. Selia e shoqërisë.

- Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: **Njësia Administrative nr. 2, Pazari i Ri, ish markata e peshkut, Tiranë.**
- Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen. Këto mund të krijohen ose mbyllen me një vendim të thjeshtë të administratorit.

5. Kohëzgjatja e shoqërisë.

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është **i pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

6. Kapitali themeltar.

- Kapitali themeltar i shoqërisë është **ALL 100.000 (njëqind mijë lekë)**
- Kapitali ndahet në **2 (dy) pjesë/kuota**.
 - Ortaku, **Marenglen Skëndi**, zotëron **50%** të kapitalit themeltar, ose 1 (një) pjesë/kuotë, me vlerë nominale **50.000 ALL (pesëdhjetë mijë) lekë**.
 - Ortaku, **Ilir Varfi**, zotëron **50%** të kapitalit themeltar, ose 1 (një) kuotë, me vlerë nominale **50.000 ALL (pesëdhjetë mijë) lekë**.

7. Organet vendimmarrëse të shoqërisë.

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve.
- Administratori.

8. Administratori

- Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Ai zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.
- Administratori i parë shoqërisë do të jetë:

- **Z. Marenglen Skëndi**

9. Likuidimi i shoqërisë

Në rast falimentimi, shoqëria do të likuidohet në përputhje me dispozitat në fuqi në legjislacionin shqiptar.


MARENGLEN SKËNDI

ORTAKËT


ILIR VARFI